



BPrAL - PPOHE
Kolegji AAB

KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE
Prishtinë

Nr. 1716 data: 25.04.2013

KOLEGJI AAB

**RREGULLORE PUNE E
KËSHILLIT DREJTUES**

PRILL 2013

Në bazë të nenit 31, 32 dhe 33 të Statutit të Kolegjit AAB dhe në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 08.01.2016 miratoi këtë:

RREGULLORE PUNE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 1

Me këtë rregullore synohet të përcaktohen rregullat e punës dhe funksionimit të Këshillit Drejtues, mënyra e marrjes së vendimeve, përbërja, kryesimi dhe vendosja dhe çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me punën e Këshillit Drejtues.

Neni 2

Sipas Statutit të Kolegjit AAB, Këshilli Drejtues është organi më i lartë drejtues i Kolegjit AAB.

Neni 3

Këshilli Drejtues përbëhet prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarëve me të drejtë vote dhe ata janë:

- 3.1. 6 (gjashtë) anëtarë të zgjedhur nga themeluesi i Kolegjit AAB;
- 3.2. 3 (tre) anëtarë të zgjedhur nga Senati, nga personeli akademik i Kolegjit AAB;
- 3.3. 1 (një) anëtarë i zgjedhur nga Senati nga mesi i personaliteteve të njohur ndërkombëtare;
- 3.4. Themeluesi i Universitetit është anëtarë i përhershëm i Këshillit Drejtues.
- 3.5. Rektori dhe Sekretari janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues pa të drejtë vote;
- 3.6. Me ftesë të Këshillit Drejtues, në mbledhjet e tij mund të marrë pjesë edhe Kryetari i Unionit të Studentëve ose ai i Parlamentit të Studentëve, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështje që kanë të bëjnë me studentët.
- 3.7. Këshilli Drejtues me shumicë votash mund të vendos për rritjen e numrit të anëtarëve të tij dhe për emërim të personaliteteve të njohura si: "ANËTARË NDERI" të Këshillit Drejtues me të drejta të plota.
- 3.8. Anëtarë të Këshillit Drejtues nuk mund të zgjedhën Rektori, Prorektorët, Sekretari, Dekanët, Prodekanët dhe Anëtarët e Senatit.

Neni 4

Përveç kompetencave të dhëna me këtë rregullore, Këshillit Drejtues do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca, por pa u kufizuar vetëm në to:

- 4.1. Miratimin e misionit dhe vizionit;
- 4.2. Miratimin e planit strategjik;
- 4.3. Përdorimin efikas të burimeve, kapaciteteve dhe ruajtjen e pronës së Institucionit;
- 4.4. Të vendosë në lidhje me themelimin, shuarjen dhe ndryshimin e strukturës së brendshme të njësive akademike dhe njësive organizative pasi që të jetë konsultuar me Senatin, si dhe të vendos për hapjen dhe shuarjen e njësive të veta nëpër qendrat e Kosovës sipas dinamikës së kërkuar;
- 4.5. Të vendosë për strukturën e përgjithshme organizative të njësive akademike, sipas propozimit të Senatit;
- 4.6. Të zgjedhë Rektorin;
- 4.7. Vendos për investime kapitale;
- 4.8. Njëherë në vit mund të kërkojë nga Menaxheri i shërbimit të financave që të informohet për gjendjen financiare, problemet dhe vështirësitë e paraqitura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
- 4.9. Të nxjerrë Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues;
- 4.10. Të vendosë për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve;
- 4.11. Vendos për lartësinë e pagesës për regjistrimin dhe shkollimin e studentëve;
- 4.12. Të vendosë për ndarjen e bursave për studentët e dalluar;
- 4.13. Mund t'i propozoj themeluesit plotësim dhe ndryshime për koston e shërbimeve;
- 4.14. Të vendosë për shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të efektshme dhe të frytshme;
- 4.15. Të nxjerrë Rregulloren për procedurën dhe masat disiplinore;
- 4.16. Të formojë komisione, në pajtim me Statutin, komisione të cilat do të merren me çështje të veçanta nga fushëveprimi i tij;
- 4.17. Të vendosë për formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës, vulës së thatë, flamurit dhe simboleve të tjera;
- 4.18. Të kryejë edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 5

- 5.1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues përgatiten dhe udhëhiqen nga themeluesi deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Drejtues.
- 5.2. Kryetari dhe Zëvendës Kryetar i Këshillit Drejtues zgjidhet nga radhët e anëtarëve me shumicë votash.
- 5.3. Kryetar i Këshillit Drejtues mund të jetë edhe themeluesi.

Neni 6

- 6.1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat 2 vjet, me mundësi të vazhdimit.
- 6.2. Mandati mund të pushojë në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit nga detyra.
- 6.3. Vendimet Këshilli Drejtues i merr me shumicë votash.
- 6.4. Në rastet kur nga votimi i të pranishmëve nuk rezulton ndonjë vendim, atëherë vota e kryetarit e ka peshën e dy votave.
- 6.5. Secili anëtar i Këshillit Drejtues mund të abstenoj prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai e vlerëson që paraqet konflikt interesi.

Neni 7

Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve më të drejtë vote.

Neni 8

Vendimet e Këshillit Drejtues pasqyrohen ne procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari ose nga Zv.Kryetari dhe nga personi i cili është ngarkuar për mbajtjen e procesverbalit.

Neni 9

Anëtarët e Këshillit Drejtues obligohen të marrin pjesë në mbledhje dhe të jenë të përgatitur për çështjet që do të diskutohen.

Neni 10

Këshilli Drejtues mbledhet pas një ftese me shkrim të Kryetarit, sa herë që është në interes të Kolegjit AAB por jo më pak se tri herë në vit. Në ftesë përcaktohet rendi i ditës, vendi dhe ora e mbledhjes, dhe ftesa shoqërohet me dokumentet e nevojshme. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit Drejtues duhet të bëhet të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjes.

Neni 11

Kryetari thërret mbledhjen e Këshillit Drejtues edhe në rastin kur për këtë bëjnë kërkesë me shkrim të paktën tre anëtarë të tij. Në këtë kërkesë përshkruhen edhe çështjet për rendin e ditës. Mbledhja duhet të mbahet jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së kërkesës.

Neni 12

Pas verifikimit të numrit të anëtarëve prezent dhe pas konstatimit të ekzistimit të kuorumit, Kryetari i Këshillit Drejtues shpall të hapur mbledhjen dhe propozon rendin e ditës.

Neni 13

Pas propozimit të rendit të ditës, Kryetari pyet anëtarët e tjerë nëse kanë propozime për të plotësuar apo ndryshuar rendin e ditës. Rendi i ditës miratohet me shumicë të thjeshtë.

Neni 14

Gjatë diskutimeve në pika të ndryshme të rendit të ditës, anëtarët duhet të shqyrtojnë të gjitha çështjet që diskutohen në mënyrë të arsyeshme. Kryetari është personi përgjegjës për t'ia dhënë fjalën diskutuesit.

Neni 15

Pas diskutimit të të gjitha pikave të rendit të ditës, Këshilli Drejtues merr vendime, nxjerr konkluzat të veçanta, rekomandime apo opinione të ndryshme.

Neni 16

Procesverbali mbahet nga procesmbajtësi që përcaktohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues. Procesverbali nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe Kryetari i Këshillit Drejtues. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, pjesëmarrësit e pranishëm, pikat kryesore të diskutimeve, vendimet, konkluzat e mbledhjes, rekomandimet apo opinionet, si dhe në fund nënshkrimet e personave kompetentë.

Neni 17

Këshilli Drejtues në mbledhjet e tij për çështje të ndryshme, mund të ftojë edhe përfaqësues tjerë të Kolegjit AAB për t'u informuar rreth punëve dhe problemeve të ndryshme

Neni 18

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen nga Këshilli Drejtues sipas të njëjtës procedurë të miratimit të saj.

Neni 19

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Kryetari i Këshillit Drejtues



Prishtinë